

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

L I G J

Nr.9210, datë 23.3.2004

**PËR STATUSIN E USHTARAKUT TË FORCAVE
TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

Ky ligj përcakton pozitën juridike, ekonomiko-financiare dhe shoqërore, kërkesat e përgjithshme të pranimit, të drejtat, detyrimet dhe kufizimet e ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, për arsye të karakterit të veçantë të detyrës dhe të shërbimit ushtarak, si dhe garancitë ligjore për zbatimin e tyre.

**Neni 2
Përkufizime**

Në kuptim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Ushtarak i Forcave të Armatosura" është shtetasi që shërben në Forcat e Armatosura, bën betimin dhe mban uniformën me shenjat përkatëse, të miratuara sipas legjislacionit në fuqi.
2. "Ushtarak i shërbimit aktiv të përhershëm" është shtetasi që shërben në Forcat e Armatosura si ushtarak (oficer, nënoficer, ushtar me pagesë/profesionist) dhe fiton statusin e karrierës, të përcaktuar në ligjin "Për gradat dhe karrierën ushtarake të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë".
3. "Ushtarak i shërbimit aktiv të përkohshëm" është shtetasi që pranon të shërbejë në Forcat e Armatosura si ushtarak (oficer, nënoficer dhe ushtar me pagesë/profesionist), për një periudhë kohe të caktuar.
4. "Ushtarak i shërbimit aktiv të detyrueshëm" është shtetasi që kryen shërbimin e detyrueshëm ushtarak, sipas ligjit.
5. "Ushtarak në rezervë" është shtetasi që ka shërbyer në Forcat e Armatosura si ushtarak aktiv (oficer, nënoficer, ushtar me pagesë/profesionist) dhe, pasi ndërpret karrierën ushtarake, sipas ligjit "Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", përfshihet në strukturat rezervë të Forcave të Armatosura si oficer, nënoficer dhe

ushtar.

6. "Ushtarak në lirim" është shtetasi që ndërpret karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura, sipas ligjit "Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë".

7. "Ushtarak në pension" është shtetasi që ka shërbyer në Forcat e Armatosura si ushtarak, aktiv dhe rezervë, dhe del në pension kur mbush moshën e pensionit të pleqërisë.

Neni 3

Shërbimi ushtarak si veprimtari e veçantë

Shërbimi ushtarak është veprimtari e veçantë, shoqërisht e domosdoshme për shtetin, që kryhet në bazë të dëshirës, vullnetit dhe detyrimit për t'i shërbyer atdheut dhe interesave të kombit, përgjegjësisë për zbatimin e legjislacionit, paanësisë politike, bindjes, profesionalizmit dhe vazhdimësisë së karrierës.

Neni 4

Pranimi në Forcat e Armatosura

1. Në Forcat e Armatosura pranohet si ushtarak aktiv shtetasi që plotëson këto kërkesa të përgjithshme:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme shëndetësore e fizike për vendin e shërbimit;
- ç) të mos jetë dënuar me burgim me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerje të një krimi;
- d) të mos jetë larguar nga puna për shkelje të disiplinës;
- dh) të jetë i moshës 19-30 vjeç;

2. Kriteret e tjera, përveç sa parashikohen në këtë nen, që duhet të plotësojë shtetasi, i cili shpreh dëshirën për t'u pranuar dhe për të shërbyer në Forcat e Armatosura, përcaktohen në ligjin "Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë" dhe në akte të tjera ligjore e nënligjore

Neni 5

Fitimi i statusit të ushtarakut

Shtetasi shqiptar, nga dita që fillon të shërbejë në Forcat e Armatosura si ushtarak, fiton statusin e ushtarakut dhe gëzon të drejtat, si dhe përmbush detyrimet e përcaktuara në këtë ligj dhe në akte të tjera ligjore dhe nënligjore.

Këtë status e gëzojnë:

- a) ushtarakët e shërbimit aktiv të përhershëm;
- b) ushtarakët e shërbimit aktiv të përkohshëm;
- c) ushtarakët e shërbimit aktiv të detyrueshëm, të thirrurit në stërvitje ushtarake, për kohën e stërvitjes;
- ç) ushtarakët në rezervë, në lirim ose në pension, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj dhe në akte të tjera ligjore e nënligjore.

Neni 6

Ruajtja e statusit kur kapet rob

Nëse gjatë kohës së veprimeve luftarake, ushtaraku aktiv mund të kapet rob, në territorin e Republikës së Shqipërisë ose në territorin e një shteti tjetër, ruan të drejtat që i njeh statusi i ushtarakut dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore.

Neni 7

Humbja e statusit të ushtarakut

1. Ushtaraku aktiv i Forcave të Armatosura e humbet statusin kur:
 - a) dënohet me burgim nga gjykata me vendim të formës së prerë për krime të kryera me dashje;
 - b) përfundon stërvitjen ushtarake ose shërbimin ushtarak aktiv të detyrueshëm;
 - c) përfundon kontratën, pa shkaqe ligjore;
 - ç) vdes.
2. Kur ushtaraku aktiv vdes, familja e tij ruan disa nga të drejtat e përcaktuara në këtë ligj.

Neni 8

Vjetërsia në punë dhe në shërbim

1. Njihet si vjetërsi në punë e ushtarakut të Forcave të Armatosura, për efekt pensioni, periudha nga data e hyrjes në shërbim të Forcave të Armatosura, si ushtar me pagesë/profesionist, kursant (nënoficer) dhe student në shkollat e larta ushtarake, brenda dhe jashtë vendit. Kontributet për sigurimet shoqërore, për këtë periudhë, përballohen nga Buxheti i Shtetit.
2. Vjetërsia e shërbimit si ushtarak aktiv, për efekt të pagës dhe përfitimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, llogaritet nga data e titullimit oficer, nënoficer, ushtar me pagesë/profesionist në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.
3. Koha e kryerjes së studimeve, pas përfundimit të shkollës së lartë ushtarake, brenda dhe jashtë vendit, llogaritet si vjetërsi në punë dhe vjetërsi shërbimi si ushtarak aktiv dhe si kohë qëndrimi në gradë.

Neni 9

Gradimi dhe karriera ushtarake

1. Shtetasi shqiptar, me pranimin në shërbimin ushtarak aktiv si ushtar, nënoficer dhe oficer, gëzon të drejtën e gradimit dhe të karrierës ushtarake.
2. Kriteret për përparimin në gradë dhe karrierë dhe ato të ndërprerjes së karrierës ushtarake përcaktohen në ligjin "Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë" dhe në akte të tjera ligjore e nënligjore.

Neni 10

Pajisja me dokumentin e identifikimit ushtarak

1. Ushtaraku aktiv, përveç letërnjoftimit/pasaportës, pajiset dhe mban kurdoherë me vete dokumentin përkatës të identifikimit ushtarak.
2. Dokumenti i identifikimit ushtarak lëshohet për oficerët nga Ministri i Mbrojtjes, ndërsa për nënoficerët dhe ushtarët profesionistë nga komandanti i forcës, komandanti i komandës mbështetëse, komandanti i njësisë në varësi të Shtabit të Përgjithshëm dhe Drejtori i Personel-Organizimit në Shtabin e Përgjithshëm.
3. Forma dhe përmbajtja e dokumentit të identifikimit përcaktohen me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm.

KREU II

TË DREJTAT DHE DETYRAT E USHTARAKUT

Neni 11

Detyra themelore

1. Është detyrë e çdo ushtaraku t'i shërbejë Republikës së Shqipërisë me besnikëri dhe ndershmëri, për të mbrojtur të drejtat dhe lirinë e popullit.
2. Është detyrë e çdo ushtaraku të respektojë rendin kushtetues.

Neni 12

Betimi i oficerit dhe nënoficerit

Ushtaraku aktiv, ditën e titullimit oficer ose nënoficer aktiv i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, bën betimin.

Formula e betimit është:

"Betohe më përpara Flamurit Kombëtar, në nderin dhe bindjen time, se do të zbatoj Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, do t'i shërbej popullit dhe Atdheut tim dhe, për mbrojtjen e tyre, nuk do të kursej as jetën time! Betohe më!"

Neni 13

Hierarkia e urdhrit

1. Ushtaraku i bindet eprorit. Ai zbaton të gjitha urdhrat që jepen për qëllime shërbimi.
2. Urdhri i ligjshëm është i detyrueshëm për zbatim edhe në rast se paraqet rrezik për jetën e ushtarakut.
3. Kur urdhri bie në kundërshtim me ligjin, ushtaraku duhet t'ia bëjë të ditur eprorit dhe të kërkojë dhënien me shkrim të urdhrit.
4. Ushtaraku nuk zbaton urdhrat që bien në kundërshtim flagrant me ligjin dhe njofton urdhërdhënësin dhe eprorin e vet.
5. Të drejtat e eprorit për dhënien e urdhrit, mënyrat e dhënies së tij dhe procedurat përcaktohen në akte të tjera ligjore.

Neni 14

E drejta për mbajtjen dhe përdorimin e armës

1. Ushtaraku aktiv, gjatë kryerjes së shërbimit dhe jashtë tij, ka të drejtë të mbajë dhe të përdorë armën vetjake, në përputhje me ligjet "Për armët" dhe "Për përdorimin e armëve të zjarrit".
2. Kur ushtaraku aktiv, për shkaqe të ndryshme, ndërpret karrierën ushtarake, dorëzon armën vetjake.
3. Ushtaraku aktiv me gradë madhore, kur del në rezervë, në lirim ose në pension pleqërie, ka të drejtën e mbajtjes së armës vetjake (pistoletë), por pasi të jetë pajisur më parë me autorizimin përkatës nga eprori i vet më i lartë. Arma vetjake i jepet pasi të regjistrohet në organet e rendit publik.
4. Kur ushtaraku vdes, familjarët janë të detyruar ta dorëzojnë armën vetjake në komandën përkatëse brenda 30 ditëve, duke njoftuar organet e rendit për çregjistrimin e saj.

Neni 15

E drejta për propozime dhe ankesa

1. Ushtarakët aktivë kanë të drejtë, në mënyrë individuale ose në grup, të bëjnë, sipas rastit, propozime, kërkesa ose ankesa për veprime të paligjshme të eprorëve, kur u preken të drejtat e tyre.
2. Propozimet, kërkesat ose ankesat u drejtohen autoriteteve dhe organeve kompetente me shkrim, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Ushtaraku nuk i nënshtrohet asnjë mase ndëshkuese ose disiplinore, për shkak të ankesës ose kërkesës së bërë prej tij.

Neni 16 **Të drejta të tjera**

Ushtaraku aktiv gëzon edhe këto të drejta:

- a) punë të garantuar në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- b) të përparojë në gradë e në rendin e përgjegjësive (karrierë), sipas akteve ligjore e nënligjore;
- c) të mbrohet nga shteti në kryerjen e detyrave të ngarkuara;
- ç) të trajnohet, të kualifikohet dhe të ndjekë studimet në institucionet arsimore, ushtarake ose civile, brenda dhe jashtë vendit, vetëm kur i jepet leje, sipas legjislacionit në fuqi dhe në përputhje me profesionin;
- d) të ushtrojë të drejtën e besimit dhe veprimtarisë fetare, jashtë territorit të repartit ose institucionit ushtarak dhe pa uniformë ushtarake;
- dh) të shërbejë brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në operacione të ndryshme ndërkombëtare, me leje të autoritetit përkatës;
- e) të përdorë veshje civile jashtë kohës së punës e të shërbimit, ose kur e kërkon natyra e shërbimit;
- ë) të organizohet në shoqata, të cilat nuk kanë karakter politik ose sindikalist.

Neni 17 **Detyrat dhe përgjegjësitë**

1. Ushtaraku aktiv i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë ka këto detyra dhe përgjegjësi kryesore:

- a) të njohë, të respektojë, të zbatojë dhe të veprojë në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
 - b) të ruajë kurdoherë nderin e dinjitetin e ushtarakut;
 - c) të shërbejë ku ta kërkojnë interesat e Forcave të Armatosura;
 - ç) të përgatitet ushtarakisht, të jetë i gatshëm dhe i disiplinuar, për çdo sakrificë, deri në dhënien e jetës për mbrojtjen e atdheut;
 - d) të sigurojë për publikun e gjerë, palët e interesuara dhe institucionet publike informacionin e kërkuar, me përjashtim të rasteve kur informacioni është i klasifikuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 - dh) të respektojë orarin e punës dhe ta shfrytëzojë vetëm për kryerjen e detyrave.
- Koha (orari) e punës dhe e shërbimit, me urdhër të eprorit, mund të zgjatet për interesa të rëndësishëm të shërbimit e të detyrës;
- e) të rrisë aftësitë profesionale dhe të marrë pjesë në veprimtari trajnuese për këtë qëllim;
 - ë) të mos kërkojë ose pranojë asnjë përfitim material, për kryerjen e detyrave, me përjashtim të pagës dhe të përfitimeve të tjera, të përcaktuara me ligj e akte të tjera nënligjore;
 - f) të mbajë përgjegjësi të plotë për ligjshmërinë e veprimeve të veta, gjatë kryerjes së detyrës;
 - g) të zbatojë rregullat e etikës.

2. Ushtaraku, përveç detyrave të përcaktuara në këtë ligj, kryen dhe përgjigjet edhe për detyra të caktuara me akte të tjera ligjore, nënligjore, rregullore ose manuale organike, të specifikuar sipas funksionit.

Neni 18 **Përgjegjësia e ushtarakut para ligjit**

1. Ushtarakët aktivë, pavarësisht nga grada dhe detyra, janë të barabartë para ligjit.
2. Për shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore, kërkesave të disiplinës ushtarake, mosushtrimit të përgjegjësive e të detyrave dhe për dëme materiale të shkaktuara ndaj pronës publike dhe private, ushtaraku mban përgjegjësi penale, civile, administrative dhe disiplinore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 19 **Ndalimet për shkak të detyrës ose të shërbimit**

1. Ushtarakut aktiv, për shkak të detyrës ose shërbimit, i ndalohet:
a) të jetë anëtar i partive politike, i organizatave ose shoqatave me karakter politik, si dhe të marrë pjesë në veprimtaritë politike që organizohen prej tyre;
b) të bëjë grevë;
c) të përdorë pronën shtetërore për përfitime vetjake;
ç) të bëjë pushime ose të shkojë për vizita tek të afërmit e tij jashtë vendit pa marrë leje me shkrim.
2. Ministri i Mbrojtjes, në zbatim të shkronjës "ç" të pikës 1 të këtij neni, nxjerr urdhër, ku përcaktohen procedurat dhe autoritetet përgjegjëse për dhënien e lejeve.

KREU III **PAGA, SHTESAT MBI PAGË DHE KOMPENSIMET**

Neni 20 **Paga dhe shtesat mbi pagë**

1. Paga e personelit ushtarak aktiv, që shërben në Forcat e Armatosura, caktohet në bazë të pagës bazë për gradën ushtarake përkatëse.
2. Paga mujore e personelit ushtarak aktiv (përfshirë ushtarët e shërbimit të detyrueshëm, ushtarët me pagesë/profesionistë, nënoficerët, oficerët, kursantët dhe studentët e shkollave të larta) përbëhet nga paga bazë dhe shtesat mbi pagë për kushte të veçanta pune e shërbimi. Paga bazë është paga për gradën ushtarake përkatëse, sipas viteve të shërbimit në Forcat e Armatosura.
Shtesa mbi pagë, për kushte të veçanta pune dhe shërbimi, jepet në një masë fikse.
3. Masa e pagës bazë për gradë, e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, kriteret dhe masa e përfitimit të shtesave mbi pagë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 21 **Kompensimet**

1. Personelit ushtarak aktiv (oficer, nënoficer, ushtar me pagesë/ profesionist) i jepet kompensim për:
a) qira banese, kur ushtaraku i shërbimit aktiv nuk mund të strehohet me banesë nga Ministria e Mbrojtjes. Masa e kompensimit është jo më shumë se 80 për qind e vlerës së qirasë;
b) ushqim.

2. Kriteret e masa e kompensimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të Ministrit të Mbrojtjes.

Neni 22

Paga e kursantit dhe e studentit ushtarak

Paga mujore e kursantit, që fillon studimet në akademitë ushtarake, pas diplomimit në universitete ose shkolla të larta, brenda dhe jashtë vendit, është e njëjtë me pagën bazë të gradës "Nëntoger".

Neni 23

Paga për ushtarakët e shërbimit në rezervë

Personeli ushtarak rezervist (oficer, nënoficer e ushtar rezervist), për kohën që thirret në shërbim ose stërvitje ushtarake në strukturat e Forcave të Armatosura, përfiton pagë dhe kompensim për ushqim për ditë shërbimi ose stërvitjeje të njëjtë me atë të ushtarakut aktiv të së njëjtës gradë ose funksion.

Paga u jepet në repartet ku personeli ushtarak rezervist (oficer, nënoficer e ushtar rezervist) kryen shërbimin ose stërvitjen.

Neni 24

Pagesa për aktivizimin e personelit ushtarak në rezervë në trajtim me pagesë kalimtare, në pension të parakohshëm ose në pension pleqërie

1. Për nevojat e Forcave të Armatosura dhe për zgjidhjen e problemeve që kërkojnë specialistë me kualifikim të veçantë, Ministri i Mbrojtjes mund të aktivizojë ushtarakë të dalë në rezervë, në lirim ose në pension.
2. Ushtaraku, kur aktivizohet, sipas pikës 1 të këtij neni, vesh uniformën ushtarake dhe përfiton pagë mujore të njëjtë me atë të ushtarakut aktiv, të të njëjtit funksion (gradë), si dhe u nënshtrohet të gjitha detyrimeve si paga e ushtarakut aktiv.
3. Ushtaraku i aktivizuar nuk mund të marrë në të njëjtën kohë pagën që i takon në zbatim të pikës 2 të këtij neni dhe pagesën kalimtare, pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi ose pensionin e pleqërisë.
4. Ushtarakut të aktivizuar i ndërpritet pagesa kalimtare, pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi ose pensioni i pleqërisë në ditën e aktivizimit.
5. Pagesa e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni përfundon ditën që ushtaraku i aktivizuar ndërpret aktivizimin dhe kthehet në statusin e tij të mëparshëm dhe rimerr pagesë kalimtare, pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi ose pensionin e pleqërisë.
6. Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Financave dhe Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale nxjerrin udhëzim të përbashkët për zbatimin e këtij neni.

Neni 25

Kompensimi në rast emërimi ose komandimi në detyrë jashtë vendbanimit

1. Ushtarakut të Forcave të Armatosura, që për nevoja shërbimi emërohet në një detyrë jashtë vendbanimit të përhershëm e, në të njëjtën kohë, transferon dhe familjen, i jepet kompensim për shpenzimet për udhëtim e transport të materialeve të shtëpisë. Shpenzimet përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.
2. Kur ushtaraku i Forcave të Armatosura komandohet në një detyrë tjetër, jashtë vendbanimit të tij të përhershëm, Ministria e Mbrojtjes i siguron fjetjen dhe transportin.

Në rastet kur fjetja dhe transporti nuk i sigurohen nga Ministria e Mbrojtjes, ai përfiton dieta, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Kriteret dhe masa e kompensimit, të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 26

Trajtimi në rast arsimimi, trajnimi ose kualifikimi

1. Ushtaraku aktiv (oficer, nënoficer, ushtar me pagesë/profesionist), për periudhën e arsimimit, të trajnimit ose të kualifikimit në kurse, shkolla të larta ushtarake (akademi) ose universitete, brenda dhe jashtë vendit, përfiton pagë dhe kompensime si më poshtë:

a) për periudha arsimimi, trajnimi ose kualifikimi në kurse dhe shkolla të larta ushtarake (akademi) ose universitete brenda vendit pagën e plotë mujore, së bashku me të gjitha kompensimet;

b) për periudha arsimimi, trajnimi ose kualifikimi në kurse dhe shkolla të larta ushtarake ose universitetet jashtë vendit pagën bazë për gradë.

2. Ministria e Mbrojtjes përballon shpenzimet për transportin, akomodimin, ushqimin dhe shpenzimet për përkujdesjen shëndetësore për ushtarakun aktiv që arsimohet, kualifikohet ose trajnohet në një vend të huaj, kur këto shpenzime nuk mbulohen nga vendi i huaj.

3. Ushtaraku aktiv (oficer, nënoficer, ushtar me pagesë/profesionist), gjatë periudhës së arsimimit, trajnimit ose kualifikimit përfiton të gjitha rritjet në pagë, si gjithë ushtarakët e tjerë në detyrë.

Neni 27

Trajtimi me uniformë

1. Ushtarakut aktiv (oficer, nënoficer, ushtar me pagesë/profesionist, ushtar i shërbimit të detyrueshëm) të Forcave të Armatosura i jepet falas uniforma ushtarake përkatëse.

2. Studentët dhe kursantët ushtarakë të shkollave të larta ushtarake, brenda dhe jashtë vendit, kursantët e Akademisë së Nënoficerëve dhe ushtarët e shërbimit të detyrueshëm pajisen me uniformë ushtarake, me grada dhe simbole të tjera që mbahen në uniformë, falas.

3. Uniforma falas, në zbatim të pikave 1 dhe 2 të këtij neni, jepet sipas kriterëve dhe normave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 28

Trajtimi i familjarëve të ushtarakut kur ushtaraku humbet jetën në detyrë ose për shkak të detyrës

1. Familja e ushtarakut aktiv të Forcave të Armatosura (oficer, nënoficer, ushtar me pagesë/profesionist, student në akademitë ushtarake brenda dhe jashtë vendit), që humbet jetën në detyrë ose për shkak të detyrës, përfiton pension familjar në masën 100 për qind të pagës mujore të muajit të fundit, pavarësisht nga periudha e sigurimit të të ndjerit.

2. Kur ushtaraku (oficer, nënoficer, ushtar me pagesë/profesionist, ushtar i shërbimit të detyrueshëm, student në akademitë ushtarake brenda dhe jashtë vendit), humbet jetën gjatë kryerjes së detyrës, në operacione ndërkombëtare ose operacione në ndihmë të popullsisë brenda vendit, familja e tij përfiton kompensim të veçantë, masa e të cilit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Fëmijëve të ushtarakut që ka humbur jetën në detyrë ose për shkak të detyrës, kur fitojnë të drejtën e ndjekjes së arsimit të lartë, shteti u jep bursë të plotë.

Neni 29

Trajtimi në rastet e ndërprejes së karrierës për shkak gjymtimi

1. Kur ushtaraku aktiv (oficer, nënoficer, ushtar me pagesë/profesionist) i Forcave të Armatosura lirohet nga shërbimi si rezultat i një gjymtimi fizik ose mendor, në detyrë ose për shkak të detyrës, duke humbur plotësisht aftësinë për punë, përfiton pension në masën 100 për qind të pagës mujore të ushtarakut në detyrë.
2. Kur ushtaraku aktiv (oficer, nënoficer, ushtar me pagesë/profesionist, student në akademitë ushtarake brenda dhe jashtë vendit) i Forcave të Armatosura lirohet nga shërbimi në Forcat e Armatosura për arsye shëndetësore, përfiton trajtim financiar deri në punësimin e tij ose deri në daljen në pension pleqërie, në masën dhe sipas kriterëve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.
Personat të cilët plotësojnë kushtet e përcaktuara në ligjin për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve, për pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, kanë të drejtën e zgjedhjes ndërmjet këtij trajtimi financiar dhe pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi.
3. Ushtaraku ka të drejtën e zgjedhjes së përfitimit të pensionit, sipas pikës 1 të këtij neni ose sipas nenit 14 të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror", i ndryshuar.

Neni 30

Ndihma financiare në raste vdekjeje, sëmundjeje ose fatkeqësie

1. Në rastet kur ushtaraku aktiv (oficeri, nënoficeri, ushtari me pagesë/profesionist) i Forcave të Armatosura vdes, pëson sëmundje të rëndë e të gjatë ose dëmtime të mëdha të pronës, si rezultat i një fatkeqësie natyrore, familjes ose atij i jepet ndihmë financiare e menjëhershme në masën deri në gjashtë paga mujore.
2. Në rastet kur ushtarakut aktiv i vdes bashkëshorti/bashkëshortja ose një familjar në ngarkim të tij pëson sëmundje të rëndë e të gjatë ose vdes i jepet ndihmë financiare e menjëhershme në masën deri në tri paga mujore.
3. Kur studenti i shkollave të larta ushtarake, kursanti, ushtari i shërbimit të detyrueshëm dhe ushtaraku rezervist (oficer, nënoficer dhe ushtar) gjatë kohës së studimeve, shërbimit ose stërvitjes vdes, familjes i jepet ndihmë financiare e menjëhershme në masën deri në katër paga mujore të gradës së nëntogerit.
4. Kur ushtaraku rezervist (oficer, nënoficer dhe ushtar) pëson gjatë kohës së stërvitjes sëmundje të rëndë e të gjatë ose dëmtime të mëdha të pronës së tij, si rezultat i një fatkeqësie natyrore, i jepet ndihmë financiare e menjëhershme në masën e dy pagave mujore të gradës që ka.
5. Ndihamat financiare, sipas këtij neni, jepen me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm.

KREU IV

TË DREJTAT SHOQËRORE TË USHTARAKUT DHE FAMILJES SË TIJ

Neni 31

Kohëzgjatja e punës

1. Kohëzgjatja normale e punës për personelin ushtarak aktiv të Forcave të Armatosura, si rregull, është e njëjtë me atë të administratës publike. Ministri i Mbrojtjes miraton orarin normal të punës për të gjithë personelin e Forcave të Armatosura, sipas misionit dhe territorit

ku kryejnë veprimtarinë.

2. Kur e kërkon misioni i njëjësive ose situata operationale, personelit të Forcave të Armatosura i kërkohet të punojë edhe në ditët e pushimit javor dhe festave, pa të drejtë përfitimi ose pagesë suplementare.

Neni 32 **E drejta për pushim**

1. Ushtaraku aktiv i Forcave të Armatosura gëzon të drejtën e pushimit javor, pushimit vjetor të paguar dhe të pushimeve të tjera të paguara të përcaktuara në këtë ligj dhe në akte të tjera ligjore e nënligjore.
2. Kohëzgjatja e pushimit vjetor të paguar për oficerët dhe nënoficerët aktivë të Forcave të Armatosura është 45 ditë kalendarike, ndërsa për ushtarët me pagesë/ /profesionistë është 30 ditë kalendarike.
3. Kur ushtaraku, për shkak të detyrës, nuk e kryen lejen e pagueshme vjetore, paga për lejen e pakryer i jepet në pagesën e dytë të muajit mars të vitit pasardhës.
4. Kur ushtaraku, gjatë kryerjes së lejes së pagueshme vjetore, për arsye shëndetësore bëhet i paafte për punë dhe këtë e vërteton me raport mjekësor, njofton vendin e punës dhe pushimi vjetor i zgjatet për atë periudhë kohe.
5. Ushtaraku aktiv i Forcave të Armatosura, përveç pushimeve të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, ka të drejtën e pushimit të paguar edhe për rastet e martesës, martesës së fëmijës, lindjes së fëmijës, sëmundjes së rëndë ose vdekjes së bashkëshortit/bashkëshortes, fëmijës, prindërve, vëllezërve dhe motrave, pësimit të dëmtimeve nga fatkeqësitë natyrore, ndërrimit të banesës, ndërrimit të vendbanimit të përhershëm për shkak të detyrës, përgatitjes dhe mbrojtjes së titujve pasuniversitarë për punën që kryejnë, kur thirret nga organet e drejtësisë si palë, dëshmitar ose ekspert, si dhe për raste të tjera të paparashikuara, të cilat vlerësohen nga eprori i tij.
6. Ushtaraku i Forcave të Armatosura ka të drejtë që, në raste të veçanta, të kërkojë leje pa të drejtë page, për arsye shëndetësore, personale, për fëmijët, bashkëshortin/bashkëshorten ose prindërit. Kohëzgjatja maksimale e të gjitha lejeve të papaguara brenda një viti kalendarik nuk mund të jetë më e gjatë se 45 ditë.
7. Kriteret për dhënien dhe kohëzgjatjen e pushimeve, të parashikuara në pikat 5 dhe 6 të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 33 **E drejta e pushimit në shtëpitë e pushimit**

1. Ushtaraku aktiv (oficer, nënoficer, ushtar me pagesë/profesionist) i Forcave të Armatosura dhe familja e tij kanë të drejtë të pushojnë në shtëpitë e pushimit të ushtarakëve në përdorim dhe administrim të Ministrisë së Mbrojtjes.
2. Të drejtën e pushimit në shtëpitë e pushimit të ushtarakëve e ka edhe ushtaraku (oficer dhe nënoficer) në rezervë, në lirim ose në pension pleqërie, së bashku me familjen e tij. Rregullat, kriteret dhe masa e pagesës përcaktohen nga Ministri i Mbrojtjes.

Neni 34 **E drejta për pushim e ushtarëve të shërbimit të detyrueshëm aktiv**

1. Leja e pushimeve vjetore për ushtarët e shërbimit të detyrueshëm aktiv është 15 ditë për gjithë kohën e kryerjes së shërbimit.

2. Në raste gëzimi ose fatkeqësie familjare dhe kur interesat e shërbimit e lejojnë dhënien e saj, ushtarit të shërbimit aktiv i jepet 7 ditë leje, e cila llogaritet si kohë shërbimi.

Neni 35

E drejta për pension të parakohshëm

1. Oficerët, nënoficerët dhe ushtarët me pagesë/profesionistë, me vjetërsi shërbimi në Forcat e Armatosura 15 vjet për burrat dhe 12 vjet për gratë, gëzojnë të drejtën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi në masën 50 për qind të pagës mujore deri në plotësimin e kushteve për përfitimin e pensionit të pleqërisë.

Për çdo vit tjetër shërbimi mbi kufirin e mësipërm ushtarakut i jepet një shtesë pensioni në masën 2 për qind të pagës mujore.

2. Pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi nuk ndërpritet në rastin e punësimit të përfituesit.

3. Kriteret dhe kushtet e përfitimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi përcaktohen në ligjin "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror", i ndryshuar.

Neni 36

E drejta për pension suplementar

Ushtaraku aktiv (oficer, nënoficer, ushtar me pagesë/profesionist,) i Forcave të Armatosura dhe ushtarakët në rezervë, në lirim ose në pension, pavarësisht nga koha e ndërprerjes së karrierës ushtarake, përveç përfitimeve të përcaktuara në këtë ligj, përfitojnë pension suplementar për vete dhe familjen, të përcaktuar në ligjin "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror", i ndryshuar.

Neni 37

Mbrojtja shoqërore e familjes së ushtarakut

1. Kur ushtaraku aktiv (oficer, nënoficer, ushtar me pagesë/profesionist) i Forcave të Armatosura, në rastet e emërimit në detyrë jashtë vendbanimit të përhershëm të tij, brenda dhe jashtë vendit, ndërron vendbanimin së bashku me familjen dhe, si rrjedhojë e kësaj, bashkëshorti/bashkëshortja humb vendin e punës, në pamundësi të punësimit në vendbanimin e ri, i jepet pagë papunësie në masën dhe sipas kriteve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Paga e papunësisë jepet në emër të bashkëshortes/bashkëshortit.

2. Koha e qëndrimit pa punë e bashkëshortes/bashkëshortit të ushtarakut, për një periudhë deri në 7 vjet, njihet si vjetërsi siguri, për efekt përfitimi pensioni pleqërie. Kontributi për këtë periudhë përballohet nga Buxheti i Shtetit. Kriteret dhe masa përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Personat të cilët e kanë përfituar këtë të drejtë, sipas nenit 17 të ligjit nr.7496, datë 3.7.1991 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", do të vazhdojnë ta përfitojnë këtë pagesë edhe për periudhën e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, por jo më shumë se 15 vjet.

3. Bashkëshortja/bashkëshorti e/i ushtarakut e përfiton pagën e papunësisë edhe për

periudhën kur ushtaraku nxirret në rezervë, në lirim ose vdes, por jo më shumë se periudha e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.

Neni 38 **E drejta për sigurim banese**

1. Ushtarakut aktiv të Forcave të Armatosura (oficer, nënoficer, ushtar me pagesë/profesionist), të pastrehuar ose me sipërfaqe të vogël banimi, i jepet kredi për strehim nga Buxheti i Shtetit.
2. Ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura (oficer, nënoficer, ushtar me pagesë/profesionist), të cilët kur dalin në rezervë, në lirim ose në pension pleqërie dhe janë të pastrehë ose me sipërfaqe të vogël banimi trajtohen për strehim si ushtaraku aktiv.
3. Ushtaraku aktiv i Forcave të Armatosura (oficer, nënoficer, ushtar me pagesë/profesionist), i cili është trajtuar sipas këtij neni, kur del në rezervë ose në lirim dhe nuk ka shlyer detyrimet përkatëse vazhdon t'i shlyejë ato si ushtaraku aktiv.
4. Përjashtohen nga e drejta e përfitimit, sipas këtij neni, ushtarakët, të cilët dalin në lirim për shkak së dënohen me burg për krime me vendim gjykate të formës së prerë.
5. Kriteret për kredinë dhe masa e saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 39

Ushtarakëve aktivë dhe në rezervë u njihet e drejta e parablerjes për objektet së bashku me trojet funksionale, të cilat dalin të lira nga ristrukturimi i Forcave të Armatosura dhe mbeten pronë e shtetit, sipas nevojave për strehim.

Kriteret e përfitimit përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 40 **Trajtimi shëndetësor**

1. Ushtaraku aktiv i Forcave të Armatosura (oficer, nënoficer, ushtar me pagesë/profesionist) dhe pjesëtarët e familjes në ngarkim të tij, si dhe ushtari i shërbimit të detyrueshëm aktiv përfitojnë ndihmë mjekësore falas në institucionet mjekësore shtetërore ushtarake dhe civile ose në qendrat mjekësore private brenda vendit.
2. Ushtaraku aktiv i Forcave të Armatosura (oficer, nënoficer, ushtar me pagesë/profesionist) dhe pjesëtarët e familjes që janë në ngarkim të tij, si dhe ushtari i shërbimit të detyrueshëm aktiv përfitojnë ndihmë mjekësore falas në institucionet mjekësore shtetërore ushtarake dhe civile ose në qendrat mjekësore private, kur dërgohen për t'u kuruar ose për t'u diagnostikuar jashtë vendit.
3. Ushtaraku në rezervë, në lirim ose në pension (oficer, nënoficer) dhe pjesëtarët e familjes, që janë në ngarkim të tij, si dhe ushtari i shërbimit rezervë kur sëmuret në shërbim ushtarak, përfitojnë ndihmë mjekësore falas në institucionet mjekësore shtetërore ushtarake dhe civile brenda vendit.
4. Ushtaraku në rezervë, në lirim ose në pension (oficer, nënoficer) dhe pjesëtarët e familjes në ngarkim të tij, si dhe ushtari i shërbimit rezervë kur sëmuret në shërbim ushtarak, gëzojnë të drejtën për t'u kuruar ose për t'u diagnostikuar në institucionet mjekësore shtetërore jashtë vendit, duke përfituar ndihmë mjekësore falas.
5. Nga ky nen nuk përfitojnë ushtarakët, të cilët dalin në lirim për shkak se janë dënuar me burg për krime me vendim gjykate të formës së prerë.
6. Përfitimet nga ky nen përballohen nga Buxheti i Shtetit.

7. Kriteret dhe masat e përfitimit të ndihmës mjekësore falas caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 41 **Kompensimi i barnave**

1. Ushtarakut aktiv të Forcave të Armatosura (oficer, nënoficer, ushtar me pagesë/profesionist), ushtarit të shërbimit të detyrueshëm aktiv, oficerit, të cilët kanë dalë në rezervë, në lirim ose në pension pleqërie, u rimbursohen barnat në masën 80 për qind në rast se në akte të tjera nuk parashikohet një përqindje më e lartë.
2. Ushtaraku që ka marrë pjesë në operacionet ndërkombëtare përfiton rimbursim të plotë të barnave, kur shëndeti është dëmtuar gjatë operacioneve të tilla dhe kompensimi zgjat për aq kohë sa të bëhet riaftësimi shëndetësor.
3. Nga ky nen nuk përfitojnë ushtarakët që dalin në lirim për shkak se janë dënuar me burg për krime me vendim gjykatë të formës së prerë.
4. Forma dhe kriteret e rimbursimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 42 **Të drejtat e ushtarakëve në rezervë, në lirim dhe në pension**

1. Ushtarakët (oficer dhe nënoficer) në rezervë, në lirim dhe në pension, përveç të drejtave të përcaktuara në nenet e tjera të këtij ligji, gëzojnë edhe këto të drejta:
 - a) të anëtarësohen në shoqata ose në parti politike dhe të marrin pjesë në veprimtaritë e tyre;
 - b) të krijojnë shoqatat e ushtarakëve në rezervë, në lirim e në pension dhe të anëtarësohen në shoqata jopolitike;
 - c) të zgjedhin vendbanimin;
 - ç) të marrin pjesë në ceremonitë ushtarake, përvjetore armësh e shërbimi, stërvitje ushtarake, të përfaqësojnë organizatat e ushtarakëve në rezervë ose në lirim në veprimtari brenda dhe jashtë vendit;
 - d) të mbajnë dhe të përdorin (të veshin) uniformën dhe gradat ushtarake, të njësuara me funksionin (detyrën) që kanë pasur në çastin e daljes në rezervë, në lirim ose në pension pleqërie, kur marrin pjesë në veprimtaritë e përcaktuara në pikën 1 shkronja "ç" të këtij neni, si dhe në ditët e festave zyrtare.
2. Në rastet kur ndryshohet uniforma ushtarake e ushtarakëve të Forcave të Armatosura, Ministria e Mbrojtjes planifikon dhe pajis me uniformë të re, kundrejt pagesës, ushtarakët në rezervë, në lirim ose në pension pleqërie.

Neni 43 **Shoqatat e ushtarakëve në rezervë, në lirim ose në pension**

1. Shoqatat e ushtarakëve në rezervë, në lirim ose në pension krijohen dhe funksionojnë sipas legjislacionit për organizatat jofitimprurëse.
2. Mënyra e komunikimit e shoqatave të ushtarakëve në rezervë dhe në lirim me Ministrinë e Mbrojtjes, Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe institucionet shtetërore përcaktohet me marrëveshje të përbashkëta.
3. Shoqatat e ushtarakëve në rezervë dhe në lirim kanë të drejtë të anëtarësohen në Konfederatën Ndërraleate të Oficerëve në Rezervë e në Lirim të NATO-s (CIOR) dhe në organizata të tjera.
4. Shpenzimet për përballimin e pagesës së kuotës së anëtarësisë dhe pjesëmarrjes në

veprimtaritë ndërkombëtare, që organizohen nga Konfederata Ndëraleate e Oficerëve në Rezervë e në Lirim të NATO-s (CIOR) përballohen nga Buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

Neni 44 **Mbrojtja e veçantë ligjore**

1. Jeta, figura dhe dinjiteti i ushtarakut dhe familjes së tij janë të paprekshme dhe mbrohen me ligj. Gjatë kryerjes së detyrës dhe për shkak të saj, ushtarakut aktiv dhe në rezervë i garantohet mbrojtja e veçantë ligjore.
2. Ushtaraku aktiv nuk mund të ndalohet dhe të arrestohet nga Policia e Shtetit, përveç kur kapet në kryerje e sipër ose menjëherë pas kryerjes së një krimi të rëndë. Ai ndalohet dhe arrestohet vetëm nga Policia Ushtarake, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Në rastet kur ushtaraku aktiv ndalohet nga Policia e Shtetit, sipas pikës 2 të këtij neni, ajo menjëherë njofton Policinë Ushtarake.
4. Në rast se për shkak të detyrës që kryen ose ka kryer, familja ose pasuria e ushtarakut rrezikohen nga veprime të paligjshme, me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes atij i garantohet mbrojtje e veçantë nga struktura të Policisë Ushtarake deri në çastin e zhdukjes së rrezikut.
5. Çdo veprim që drejtohet kundër jetës, figurës dhe dinjitetit të ushtarakut dhe familjes së tij, dënohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 45 **Ceremoniali ushtarak**

1. Veprimtaritë përkujtimore, pritja e personaliteteve të vendit dhe të huaja zhvillohen me ceremoni ushtarake.
2. Në rast se ushtaraku aktiv, në rezervë, në lirim ose në pension vdes, varrimi kryhet me ceremoni ushtarake. Shpenzimet e varrimit përballohen nga Ministria e Mbrojtjes. Instituti i Sigurimeve Shoqërore bën rimbursimin e Ministrisë së Mbrojtjes sipas kritereve të përcaktuara në dispozitat ligjore.
3. Rregullat e ceremonialit ushtarak përcaktohen në "Rregulloren e ceremonialit ushtarak", e cila miratohet nga Ministri i Mbrojtjes me propozim të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

KREU V **DISPOZITA TË FUNDIT**

Neni 46 **Ristrukturimi**

1. Në rast restrukturimi, kur bëhen ndryshime në strukturë dhe shkurtime në numrin e personelit të Forcave të Armatosura, ushtaraku, funksioni i të cilit shkurtohet dhe sistemimi ose emërimi në një detyrë tjetër, në përputhje me gradën dhe kualifikimin, është i pamundur, del në rezervë ose në lirim.
2. Ushtaraku i dalë në rezervë ose në lirim, siç përcaktohet në pikën 1 të këtij neni dhe që nuk plotëson kriteret për pension të parakohshëm, shpërblehet. Shpërblimi jepet në masën e pagës së plotë mujore për çdo vit të plotë shërbimi aktiv. Ky shpërblim jepet vetëm një herë dhe përcaktohet në urdhrin e daljes në rezervë ose në lirim.

Neni 47
Detyra dhe përgjegjësia e organeve shtetërore
për sigurimin e statusit të ushtarakut

1. Institucionet qendrore vendore dhe komandat e njësisve ushtarake, brenda kompetencave dhe në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve të tjera ligjore e nënligjore, sigurojnë realizimin e statusit të ushtarakut.
2. Për mosplotësimin e detyrimeve që përcaktohen në këtë ligj personat përgjegjës mbajnë, sipas rastit, përgjegjësi disiplinore, civile dhe penale, të cilat përcaktohen me dispozita ligjore.
3. Ministria e Arsimit dhe e Shkencës planifikon për çdo vit, në bazë të kërkesës së Ministrisë së Mbrojtjes, të drejta studimi për në fakultetet e shkollave të larta të Republikës së Shqipërisë, për fëmijët e ushtarakëve që kanë humbur jetën në detyrë ose për shkak të detyrës.

Neni 48
Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Këshilli i Ministrave, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet e nevojshme për zbatimin e neneve 20, 21, 25, 27, 28 pika 2, 29 pika 2, 32 pika 7, 38 dhe 39 të këtij ligji.
2. Këshilli i Ministrave, brenda 24 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet e nevojshme për zbatimin e neneve 37 pikat 1 dhe 2, 40 dhe 41 të këtij ligji dhe të paraqesë ndryshimet përkatëse në ligjin nr.8087, datë 13.3.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror", i ndryshuar, në zbatim të neneve 35 dhe 36 të këtij ligji.
3. Ministria e Financave, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe Ministria e Mbrojtjes, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, në bashkëpunim me njëra-tjetrën të nxjerrin udhëzimin e përbashkët për zbatimin e nenit 24 pika 6 të këtij ligji.
4. Ministria e Arsimit dhe e Shkencës dhe Ministria e Mbrojtjes, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, në bashkëpunim me njëra-tjetrën të lidhin një aktmarrëveshje për zbatimin e nenit 47 pika 3 të këtij ligji.
5. Ministria e Mbrojtjes, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet e nevojshme për zbatimin e neneve 10 pika 3, 19 pika 2, 31 pika 1, 33 dhe 45 të këtij ligji.

Neni 49
Shfuqizime

Ligji nr.7496, datë 3.7.1991 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", neni 50 i ligjit nr.7978, datë 26.7.1995 "Për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", shprehja "por jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi" në shkronjën "b" të nenit 11 të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror", i ndryshuar, si dhe të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore, që janë në kundërshtim me kërkesat e këtij ligji, shfuqizohen.

Neni 50

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I
Servet Pëllumbi